



Rregullorja për lehtësirat për investuesin e jashtëm dhe bizneset vendore fillestare

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 20/2008), të dispozitave të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, e me qëllim të zhvillimit të ekonomisë përmes krijimit të një tregu të qëndrueshëm në Komunën e Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2012, nxjerr këtë

R R E G U L L O R E

**PËR LEHTËSIRAT PËR INVESTUESIT E JASHTËM DHE BIZNESET
VENDORE FILLESTARE**

QËLLIMI

Neni 1

Më këtë Rregullore krijohet mundësia që komunën e Rahovecit ta bëjmë më tërheqëse për investuesit e huaj dhe për themelimin e bizneseve vendore fillestare.

PËRKUFIZIMET

Neni 2

2.1 Sipas kësaj Rregulloreje:

-**"Komunë"** do të thotë njësi territoriale - administrative, në të cilën qytetarët e saj e realizojnë vetëqeverisjen;

-**"Organizata biznesore"** do të thotë shoqëri e themeluar sipas ligjit në fuqi në Kosovë, me qëllim të ushtrimit të biznesit;

-**"Investues i huaj"** do të thotë organizatë afariste që ka së paku njëzet e pesë për qind në pronësi të investitorit të huaj;

-**"Biznes vendor fillestar"** do të thotë:

shoqëri tregtare e cila veprimtari primare ka prodhimtarinë, të gjitha shoqëritë që punësojnë së paku 5 punëtorë, dhe shoqëri e cila merret me hulumtime shkencore, aplikimin e "know - how" teknologjisë dhe teknologjisë së IT-së.

“Trajtim i njëjtë” do të thotë se investuesit e huaj në komunë nuk do të trajtohen më pak të favorshëm se shoqëritë e ngjashme afariste vendore.

TRAJTIMI I NJËJTË

Neni 3

“Trajtimi i njëjtë” nënkupton që:

- a) shoqëritë tregtare, të përkufizuara si investitor i huaj, sipas kësaj Rregulloreje, do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si shoqëritë afariste vendore;
- b) investuesit e huaj kanë të drejtë të njëjtë në shfrytëzimin e pasurisë së patundshme dhe pasurisë së tundshme, ashtu sikurse edhe shoqëritë vendore;
- c) investuesi i huaj nuk mund të obligohet me tatim në mënyrë të njëanshme (më pak të favorshme) se një shoqëri e ngjashme vendore.

KËRKESA

Neni 4

Për investuesin e huaj dhe biznesin fillestar kërkohet paraqitja e një deklarate për identifikim, me qëllim të mbledhjes së shënimeve statistikore për identifikim dhe fillimin e privilegjeve të statusit të investuesit të huaj dhe biznesit vendor.

ZBATIMI I RREGULLAVE TË KOMUNËS

Neni 5

Investuesi i huaj dhe ai vendor duhet t’u përmbahen rregullave të Komunës si p.sh:

- a) të sigurojnë pëlqimin për kryerjen e veprimtarisë afariste, sipas infrastrukturës ligjore që është në fuqi në Republikën e Kosovës për llojin e veprimtarisë që do të ushtroj;
- b) të bëjnë mbajtjen e librave afariste dhe regjistrimet në të njëjtat standarde kontabël;
- c) të paguajnë tatimet sipas ligjeve dhe rregulloreve të ATK-se.
- d) të paraqet Planin e Investimeve, me vlerën, teknologjinë dhe planin e punësimit
- e) të paraqet dokumente financiare për firmën e vet, si dëshmi e biznesit të suksesshëm.

Komuna obligohet që:

- a) të krijojë ambient të përshtatshëm për infrastrukturë në bazë të “Planit zhvillimor strategjik të Rahovecit”;
- b) të lirojë nga pagesa e taksave komunale për 5 vitesh e para, prej ditës së themelimit të Shoqërisë;
- c) të bëjë lirim prej 50 %, pas 5 vitesh të themelimit të Shoqërisë, deri në vitin e gjashtë të afarizmit, me kusht që Shoqëria të sigurojë aktivitet të vazhdueshëm me plane afatgjata.
- d) të ulë taksë e tarifa për 50% të përcaktuara me rregullore në fuqi të komunës, sipas nevojës së parashtruar nga ana e Investuesit të huaj apo vendor në :
- Shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore
 - taksë për ndërtimin e objektit prodhues për m²
 - ti rregulloj dhe ti përgatitë të gjitha dokumente administrative –si leja e urbanizmit ,kopja e planit, pronësia e komunës etj,
 - lehtësimet tjera ad hoc varësisht nga mundësia e Komunës dhe veprimtaria e investuesit (brenda ligjeve dhe rregulloreve në fuqi).
- e) në rast të dhënies së informacioneve jo të sakta, pasojnë konsekuenca sipas Ligjit për Investimet e Jashtme.
- f) Investitori vendor apo i huaj i cili veprimtarinë e vet e ndërpret para afatit 5 vjeçar, obligohet që për vitet e afarizmit t’i përmbush të gjitha obligimet sipas rregulloreve komunale në fuqi. Në të kundërtën biznesit të njëjtë nuk i lejohet marrja e pëlqimit të dytë për veprimtari e cila mund të bartet në emër të titullari tjetër të afërt me pronarin e mëhershëm.

PUNA DHE PUNËSIMI

Neni 6

Punonjësit e investuesve të huaj dhe të bizneseve vendore fillestare i nënshtrohen ligjeve që janë në fuqi në Kosovë. Punësimi rregullohet duke aplikuar dispozitat e Ligjit themelor të punës në Kosovë dhe Kontratës kolektive, e cila aplikohet nga fillimi i vitit 2011.

ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 7

Zgjidhja e kontesteve afariste do të bëhet me mirëbesim, nëse kjo nuk është e mundur, e në rast kontesti kompetente është Gjykata Ekonomike e Kosovës.

HYRJA NË FUQI

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e 8 nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve.

01 Nr. 1939
Rahovec, 30.04. 2012

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa